

UMBERTO ECO

PORTRET I NJË BACHELOR

Qysh në rini, Joyce vendosi që gramatika ishte shkenca më e rëndësishme. Që atëherë ai tregohet i patundshëm në këtë çështje dhe për të lufta në kërkim të së vërtetës bëhet luftë në kërkim të një gjuhe të përsosur. Është ky një mit i gjuhës edenike dhe universale, mit ndaj të cilit as Eco, s'ka qëndruar i pandieshëm, sikundër dëshmon kjo konferencë e tij e mbajtur në Dublin.

Bachelors

Ka mundësi të mos jem oratori më i përshtatshëm për të celebruar Bachelors of art të Jouce, sepse në një artikull të botuar në "St. Stephen's Magazine" thuhej se Joyce ka qenë i prishur nga idetë që vinin nga Italia. Por sigurisht nuk kam drejtuar një lutje me shkrim për këtë konferencë, dhe përgjegjësia është e University Collegs. Titulli i konferencës sime është Portrait of the artist as a bachelor, ndoshta loja ime ndërtekstuale nuk është ndër më të hollat, por jam veç një playboy of the southern world.

Ndihem megjithatë ngusht me titullin që kam zgjedhur: do të dëshiroja të flisja për kohët në të cilat Jim, në Conglowes Wood College, denonconte moshën e tij duke thënë "I am half past six". Por të mos largohemi nga argumenti dhe të okupohemi me Joyce në cilësinë e "bachelor".

Çfarë do të thotë në anglisht "bachelor"? Mundet që ju të gjithë ta dini që në shumë studime te semantikës kontemporane "bachelor" është bërë një fjalë magjike qëkur ka qenë trashëguar autor pas autori, ky shembull sovran i termit të dyfishtë që ka të

Estetikë

paktën 4 kuptime të ndryshme. Një "bachelor" është (I) një mashkull i rritur ende i pamartuar, (II) një kalorës i ri në shërbim të një tjetri, (III) një person që ka marrë shkallën e parë ta laurës, (IV) një fokë mashkull që nuk arrin të çiftëzohet gjatë stinës së dashurive.

Megjithatë gjuhëtari i madh Roman Jakobson, vuri re njëherë se me gjithë ndryshimet e tyre semantike, këto katër homonime kanë një notë të përbashkët të pakompletuar apo të paktën të pambaruar. Një "bachelor" është pra në çdo rast diçka që nuk ka arritur ende në një gjendje pjekurie. I riu mashkull nuk është ende një burrë dhe një baba i pjekur, pazhi nuk është ende një kalorës puplak; akademiku i gradës së parë nuk është ende profesor, as Doktor në Filozofi dhe i shkreti mashkull i fokës ende nuk ka zbuluar kënaqësitë e seksit.

Në kohën në të cilën la University College, Jim ynë ishte ende një Joyce i paplotësuar? Sigurisht, përderisa nuk i kishte shkruar ende ato vepra, pa të cilat Joyce do të kishte mbetur një matrikull arrogant; megjithatë do të vija në dukje se pavarësisht nga kjo, në fund të studimeve të tij, Jim nuk ishte aq i paplotësuar sa do të besohej, dhe që pikërisht gjatë atyre viteve vizatoi ndritshëm, në tentativat e tij të para të shkrimeve, gjithë ato shtigje që do të ndiqte në moshë të pjekur.

Jim e nisi curriculum e tij më 1898 duke mësuar anglishten nën drejtimin e Padër O'Neill një ndjekës patetik i "BaconShakespeare Controversy", italishten nën drejtimin e Padër Ghezzi dhe frëngjishten me Eduard Cadic. Ishte epoka e studimeve neotomistike, ato që shpesh tregonin rrugën më të shkurtër për të keqkuptuar Akuinin, por në College sigurisht, e më parë në Pola e në Paris Notebook, Jim kuptoi diçka të saktë se është e vërtetë ajo që thotë Stanislaus, që Tomas D'Akuini është një mendimtar mjaft kompleks, mbasi ajo që thotë i ngjan ekzaktësisht asaj që thotë njeriu i zakonshëm, apo ajo që ai don të thotë - kjo gjë më duket rruga më e mirë për të kuptuar esencën e vërtetë të filozofisë së shën Tomasit.

Fillimet

Në konferencën e tij *Drama and life* të mbajtur me 20 janar

1900 në University College Literary and Historical Society, Joyce shpalli poetikën e *Dubliners*: "E pra mendoj, që nga monotonia e ekzistencës mund të nxirren aspekte të dramës së jetës. Më i madhi vend i rëndomtë, më i vdekuri në mes të të gjallëve, mund të ketë një pjesë në këtë dramë".

Në *Ibsen's New Drama*, botuar me 1 prill 1900 në "Fortinghtly Review" mund të gjejmë idenë themelore të impersonalitetit artistik që më në fund do ta rigjejmë tek *Portrait*. "Ibsen ... e sheh në intervale të rregullta dhe complete, si nga një lartësi e pamatë, me një vizion perfekt dhe me paanësi engjëlllore, me shikimin e atij që mund ta shohë diellin me sy hapur" (CW65), dhe Zoti tek *Portrait* qëndron "brenda apo jashtë, apo përtej, apo sipër veprës së tij, i padukshëm, i stërholluar deri në zhdukje, indiferent, i zënë me përkujdesjen ndaj thonjve." Në James Clarence Mangan, një konferencë me 15 shkurt 1902 drejtuar Literary and Historical Society of the University College, dhe pastaj botuar në maj në "St. Stephen's Magazine" gjejmë që "Bukuria, shkëlqimi i së vërtetës është një prani e këndshme kur imagjinata sodit fuqishëm realitetin e qenies së vet dhe botën e shikueshme dhe shpirtin shenjt të ngazëllimit. Këto janë realitet dhe këto përballojnë e japin jetë" (CW83), Kjo është padyshim para urë e nocionit të epifanisë që pastaj është zhvilluar në punimet e mëtejshme.

Në veprën *The study of language*, një ese e shkruar gjatë vitit të parë të Universitetit (1898 - 1899) vemë re një afirmim impresionues që rri në themel të strukturës së *Ulysses*; autori i ri flet për një gjuhë artistike që i ikën "asaj vrazhdësie që është e mjaftueshme vetëm për shprehjet e shpëlara, në sajë të një influence të mbingarkuar të asaj që është e bukur në frazat patetike, një agjërimit të fjalëve, të rrëkeve invektive, metaforave dhe llojeve të figurave, që ruajnë edhe në çastet e emocioneve më të mëdha, një simetri të bashkëlindur".

Në të njëjtin tekst mundemi gjithashtu të veçojmë një jehonë të largët të *Finnegans Wake* e të leximit të ardhshëm të Vico kur Joyce thotë që "në historinë e fjalëve ka shumë që tregon historinë e njeriut, dhe duke krahasuar gjuhën e sotme me atë të shumë viteve më parë, të kemi një paraqitje të nevojshme të efektit të influencave të jashtme në gjuhën autentike të një race".

Nga ana tjetër obsesioni themelor i Joyce, kërkimi i një të vërtete artistike nëpërmes manipulimit të të gjitha gjuhëve të botës, zbulon një pjesë tjetër të kësaj eseje rinore kur Jim, ende matrikull, shkruan që "shkallët më të larta të gjuhës, stili, sintaksa, poezia, oratoria dhe retorika janë, pra duhet t' i konsiderojmë, kampionët dhe përfaqësuesit e së vërtetës".

Nëse është e vërtetë që çdo autor zhvillon një ide të vetme farë gjatë gjithë jetës së tij, kjo duket veçanërisht e goditur për Joyce: ende jo "bachelor" e dinte saktësisht çfarë do të bënte: dhe e thoshte, edhe pse në mënyrë jo të formuar e megjithatë të çiltër. Apo nëse preferoni, vendosi të bënte në moshe të pjekur atë që arriti të parashikonte në këto salla. Në vitin e parë të studimeve meditoi mbi paraqitjen e shkencave në Shën Maria Novella dhe vendosi që Gramatika ishte "e para" e shkencave". Ia kushoi kështu pjesën tjetër të jetës shpikjes së një gramatike të re dhe kërkimi i së vërtetës u bë kërkimi i një gjuhe perfekte.

Kërkimi i një gjuhe perfekte

Në vitin në të cilin Dublini u celebrua si kryeqytet kulturor europian është e arsyeshme të reflektojmë mbi faktin se kërkimi i një gjuhe perfekte ishte dhe vazhdon të jetë një fenomen tipik europian. Europa lindi nga një bërthamë unike gjuhësh e kulturësh (bota e Greqisë antike dhe e Romës antike) dhe më pas përballoi ndarjen në gjuhë të ndryshme dhe kombe të ndryshme. Bota antike nuk ishte e shqetësuar as nga problemi i një gjuhe perfekte, as nga shumëfishimi i gjuhëve. Koineja elenistike fillimisht dhe latinishtja imperiale më pas, siguruan një sistem të kënaqshëm komunikimi universal nga pellgu mesdhetar gjer tek ishujt britanikë. Dy popujt që kishin shpikur gjuhën e filozofisë dhe gjuhën e ligjit identifikonin strukturat e gjuhëve të tyre me strukturat e arsyes njerëzore. Njeriu grek fliste g j u h ë, gjithë të tjerët ishin barbarë, pra, në terma etimologjikë, njerëz që belbëzonin, që ishin të privuar nga gjuha.

Rënia e perandorisë romake shënoi fillimin e një periudhe ndarjesh gjuhësore e politike. Latini u prish. Barbarët bënë kryengritje me gjuhët e tyre e me zakonet e tyre. Gjysma e zotërimeve romake u kaloi përfundimisht grekëve të perandorisë së

lindjes. Një pjesë e Europës dhe gjithë pellgu mesdhetar filluan të flisnin arabisht. Në fillimin e mijëvjeçarit të ri do ë dilnin në dritë gjuhët kombëtare.

Është saktësisht ky çast historik kur kultura kristiane filloi të rilevojë faqet e Biblës mbi confusio linguarum që u vu re gjatë ndërtimit të Kullës së Babelit dhe filloi të shqetësohej rreth mundësisë së rizbulimit apo të rishpikjes të një gjuhe para-babelike, një gjuhë të përgjithshme për mbarë njerëzimin, e aftë të shprehë natyrën e gjërave përmes një lloj homologjie të bashkëlindur mes sendeve dhe fjalëve. Kërkimi i tillë i një sistemi komunikimi universal mori forma të ndryshme, qe si një kthim prapa në kohë në përpjekje për të rizbuluar gjuhën që origjinalisht Adami fliste me Zotin, qe si një ecje përpara duke u përpjekur për të ndërtuar një gjuhë më dhunti të arsyeshme të asaj përsosmërie të humbur që i përkiste gjuhës së Adamit. Në secilin rast kërkohet të ndiqej ideali i Vico që ishte për gjetjen e një gjuhe mendore e të përbashkët për gjithë popujt. Të tilla kërkime vazhdojnë ende sot, nga njera anë me shpikjen e gjuhëve ndërkombëtare si Esperanto, nga ana tjetër me përpjekjet e larmishme për të krijuar një "gjuhë mendore" që qoftë njerëzit, qoftë kompiuterët të jenë në gjendje ta flasin e ta kuptojnë.

Megjithatë në rrjedhën e këtyre kërkimeve pati mjaft raste në të cilat ndokush vuri re që gjuha e vetme e përsosur, qe ajo e folur prej bashkëatdhetarëve të tij.

Në shekullin XVIII Georg Philip Harsdorffer pohoi se Adami mund të fliste veç gjermanisht, mbasi vetëm në gjermanisht rrënjët paraqesin përsosmërisht natyrën e gjërave (më vonë Heidegger thoshte se mund të bëhej filozofi vetëm në gjermanisht). Antoni de Rivarol (Discours sur l'universalite de la langue française, 1784) pohoi se frëngjishtja qe gjuha e vetme në të cilën struktura sintaksore e frazave pasqyronte strukturën autenike të arsyes njerëzore dhe pra qe gjuha unike logjike në botë (gjermanishtja ishte tepër grykore, italishtja tepër e ëmbël, spanjishtja tepër e rënduar, anglishtja tepër e errët).

Dante

Dihet mirë që në këtë College, Joyce u bë një entuziast i Dante

Aligjerit dhe që i tillë mbeti për gjithë jetën. Të gjitha referimet e tij ndaj Dantes i përkasin vetëm Komedisë Hyjnore, por ka arsye të forta për të besuar që kishte edhe një lloj familjariteti me idetë e Dantes që i përkisnin origjinës së gjuhës dhe me projektin e tij për të krijuar një gjuhë të re poetike të përsosur, ashtu si vetë dante i shprehu në *De vulgari elequentia*. Në çdo rast Joyce duhet të ketë gjetur në Komedinë Hyjnore referime të qarta të një versioni të ri të diskutimit antik pikërisht për gjuhën akademike. *De vulgari elequentia* që shkruar më 1303 - 1305, e pra para Komedisë Hyjnore. Edhe pse duket si një disertacion doktrinal, në realitet është një vetkoment në të cilin autori përpiqet të analizojë metodat e tij të prodhimit artistik që ai i vetidentifikon në mënyrë të heshtur me modelin e çdo bisede poetike. Sipas Dantes shumësia e gjuhëve popullore ka qenë e paraprirë, para mëkatit babelik, nga një gjuhë e përsosur me të cilën Adami komunikonte me Zotin dhe me të cilën pasardhësit e tij flisnin midis tyre. Mbas kaosit babelik gjuhët u shumëfishuan nëpër zona të ndryshme gjeografike të botës dhe më pas brenda kwsaj zone që sot e quajmë Romanza, në të cilën qenë ndarë në mes të gjuhës të si, gjuhës të oc dhe gjuhës të oil. Gjuha e si, apo italiane, u shpërnda në një shumëfishim dialektesh që nganjëherë ndryshojnë edhe nga njëra zonë e qytetit tek tjetra. Kjo thyerje i detyrohet natyrës së paqëndrueshme e të lëvizshme të njeriut, zakoneve të tij dhe shprehive verbale qoftë në kohë, qoftë në hapësirë. Pikërisht për kompensimin e këtyre ndryshimeve të lehta e të pashterrshme në gjuhën natyrale, shpikësit e gramatikës kërkojnë një lloj gjuhe të pandryshueshme që të mbetet identike në kohë e në hapësirë, dhe kjo gjuhë që latinishtja e folur nëpër shekujt e Mesjetës nëpër Universitete. Por Dante kërkon një latinishte popullore, dhe në sajë të kulturës së tij poetike dhe të kontakteve të tij rrugëve të mërgimit eksperimentoi qoftë llojet e dialekteve italiane, qoftë llojet e gjuhëve europiane. Synimi i *De vulgari elequentia* është që të identifikojë një gjuhë më me dinjitet e më fisnike, e për këtë arsye Dante proçedon përmes një analize rigoroze kritike të italishtes dialektore. Nga çasti që poetët më të mirë, sipas mënyrës së tyre, kanë marrë distancë nga dialekti i tyre rajonal, kjo sugjeron mundësinë për të gjetur një "dialekt të zgjedhur", një volgare illustre (ku "illu-

stre" do të thotë "shpërndarës drite"), i denjë të zërë vend në palatin mbretëror të një mbretërie kombëtare, nëse ndonjëherë italianët do të duhej ta kishin një, e pra një gjuhë kombëtare. Bëhet fjalë për një dialekt të përbashkët për të gjitha qytetet italiane dhe për asnjërin në veçanti, një lloj ligji ideal, të cilit poetët më të mirë i janë afruar, dhe në krahasim me të - si rregull ideal - gjithë dialektet ekzistuese do të jenë të gjykuara. Pra, në kontrast me konfuzionin e gjuhëve të ndryshme, Dante duket se propozon një gjuhë poetike të ngjashme me gjuhën e Adamit që i përgjigjet gjuhës poetike, për të cilën ai konsiderohet krenarisht themelues. Kjo gjuhë e përsosur mbi të cilën Dante hidhet në gjah si një "panterë e profumuar", shfaqet herë pas here në veprat e atyre poetëve që Dante i konsideron të mëdhenj, megjithëse ende mjaft të paformë, jo të kodifikuar mirë dhe me parime gramatikore jo krejt të qarta.

I ndodhur përballë qënies së dialekteve, natyrale, por jo universale, dhe gramatikës latine, Dante vazhdoi ëndrrën e tij për të restauruar një gjuhë edenike që të ishte në të njëjtën kohë natyrale dhe universale. Por në ndryshim me kërkesat rilindase për një gjuhë hebraike origjinale, Dante synoi të rikrijonte gjëndjen origjinale me një gjest të shpikjes moderne. Popullorja e ndritshme, prej së cilës gjuha e tij poetike ka qenë shembulli më i mirë, është rruga përmes së cilës një poet "modern" do të shëronte plagën pas - babelike.

Ky konceptim i guximshëm i rolit të tij si restaurues i një gjuhe të përsosur shpjegon pse në *De vulgari eloquentia*, Dante, në vend që të dënonte shumësinë e gjuhëve, vë në dukje forcën e tyre biologjike, aftësinë e tyre të rinovimit përtej kohës. Pikërisht mbi bazën e kësaj krijimtarie gjuhësore ai është i aftë të nisë shpikjen e një gjuhe të përsosur, moderne e natyrale, pa u kthyer prapa në kohë në kërkimin e modeleve të humbura. Nëse Dante do të kishte besuar që gjuha e zanafillës të kishte përkime në gjuhën hebraike, do të kishte vendosur patjetër që ta përdorte. Por për një mundësi të tillë nuk ka menduar kurrë mbasi ishte i sigurtë që mund të gjente ende, përmes një perfeksionimi të dialekteve të ndryshme italiane, atë gjuhë universale për të cilën gjuha hebraike kishte qenë mishërimi më i famshëm.

Shumë nga pohimet arrogante të të riut Joyce duket se alu-

dojnë ndaj së njëjtës detyrë për të restauruar kushtet e një gjuhe të përsosur përmes shpikjes së tij vetiake poetike me qëllim që të formojë "ndërgjegjen e pakrijuar" të racës së tij, një gjuhë që nuk do të jetë arbitrare si gjuha e përbashkët, (e përgjithshme), por e nevojshme dhe e motivuar. Në këtë mënyrë, në mënyrë misterioze dhe përsosmërisht, bachelor i ri kuptoi idenë e Dantes dhe e ndoqi gjatë gjithë jetës së tij.

Prapë se prapë projekti i Dantes, si çdo projekt tjetër për një gjuhë të përsosur, ishte ai për gjetjen e një gjuhe që i lejonte njerëzimit t'i ikte labirinthit pas - babelik. Kishte mundësi, siç i ndodhi Dantes, të pranojë shumësinë pozitive të gjuhëve, por një gjuhë e përsosur duhej të ishte e qartë dhe e komunikueshme, jo në formë labirinthi. Përkundrazi, projekti i Joyce, në masen në të cilën ai largohet në mënyrë progresive nga estetika e tij e parë tomiste për t'iu afruar vizionit të botës të shprehur tek *Finnegans Wake*, duket se është si për të tejkaluar kaosin pas - babelik përmes pranimit e shfrytëzimit të këtij të fundit. Joyce nuk kërkoi asnjëherë të vendosej para ose përtej kullës, ai donte të jetonte brenda - dhe më lejoni t'ju pyes nëse vallë vendimi për ta filluar *Ulysses* në majën e një kulle, të mos jetë parapërfytyrim i pandërgjegjshëm i qëllimit përfundimtar të Joyce, pra të formojë një furrë shkrirjeje "poligluttural" dhe "multilingual" që paraqet triumfin e *confusio linguarum*. Çila që pra origjina e largët e një vendimi të tillë?

Gramatikanët e parë irlandezë

Rreth gjysmës së parë të shekullit VII pas Krishtit u duk në Irlandë një traktat gramatike titulli i të cilit ishte *Auraicept na n-Eces*, që kam dëshirë ta quaj *Rregullat e poetëve*. Ideja themelore e këtij traktati është që me qëllimin e adaptimit të modelit gramatikor latin në irlandisht duhet të imitohet struktura e Kullës së Babelit: tetë apo nëntë (sipas versioneve të ndryshme të tekstit) janë pjesët e ligjërimit, pra emra, folje, ndajfolje e kështu me radhë - dhe tetë apo nëntë janë elementët kryesore të përdorura për ndërtimin e Kullës (ujë, gjak, baltë, dru e kështu me radhë). Përse një paralel i tillë? Përse 72 specialistët e shkollës së Fenius Farsaid, që projektuan gjuhën e parë të lindur dhjetë vite pas

kaosit pas - babelik kërkonin të ndërtonin një idiomë që, si ajo origjinale të ishte jo vetëm homologe me natyrën e gjërave, por edhe të ishte në gjendje të përmbledhonte natyrën e gjithë gjuhëve të tjera të lindura pas kaosit. Propozimi ishte i frymzuar nga Isai 66. 18, "Do të vij e do të bashkoj çdo gjuhë e çdo komb". Metoda që përdornin qendronte në seleksionimin e thelbit të çdo idiome duke kapërcyer gjuhët e tjera, dhe duke i kombinuar këto fragmente në një strukturë të re e të përsosur. Edhe mund të thuhet që ata e bënë një punë të tillë me të vërtetë artistike, siç thotë Joyce "artisti që don ta mbështjellë me mjaft saktësi shpirtin e hollë të përfytyrimit nga rrjeta e rrethanave të përcaktuara mirë që i rrinë përreth, dhe rrethanave artistike, të zgjedhura si më të sakta për të në detyrën e tij të re, ishte artisti më i madh" (Stephen Hero, përkthimi italisht, faqe 96).

Me pre apo me nda - që është sot një kategori themelore në shpjegimin e sistemeve gjuhësore - ishte kaq e rëndësishme për këta 72 specialistë, sa që fjala teipe e përdorur për të ndarë në pjesë, pra për të përzgjedhur, për të modeluar, dëshmon automatikisht gjuhën irlandeze berla teipide. Për rrjedhim Auraicept në cilësinë e tekstit që përkufizon një ngjarje të tillë, u konsiderua një alegori e botës.

Është interesante të vemë re se një teori gati e njëjtë që shprehur nga një bashkëkohës i Dantes, kabalisti i madh i shekullit XXII Abraham Abufalia, sipas të cilit Zoti i kishte dhënë Adamit jo një gjuhë të veçantë, por një lloj metode, një gramatikë universale, që e humbur në skandalin e Babelit, mbijetonte mes popullit hebre, që që atë në përdorimin e kësaj rregulle për të krijuar gjuhën hebraike, më të përsosurën e 70 gjuhëve pas - babelike. Por hebraishtja për të cilën fliste Abufalia nuk qe një kolazh i gjuhëve të tjera, se sa një trup krejt i ri, i prodhuar duke kombinuar 22 gërmat origjinale (segmentet elementare) të alfabetit hyjnor.

Përkundrazi, gramatikanët irlandezë nuk vendosën të ktheheshin në kërkim të gjuhës së humbur të Adamit, por preferuan të ndërtojnë një të re dhe të përsosur për të identifikuar me të idomat kombëtare, një gjuhë e cila nuk duhej të shpikëj duke fshirë përvojën e gjuhëve ekzistuese pas - babelike.

Poblemi në thelb është ky: a e njihte Joyce këtë teori të irlan-

dishtes si gjuhë e përsosur? Nuk kam gjetur asnjë referim me Aureicept në veprën e Joyce, por më ka bërë kurioz fakti i sjellë nga Ellmann, që i riu "bachelor" në tetorin e 1901 në asamblenë e Laë Student Debating Society, shkoi në konferencën e John F. Taylor ku jo vetëm që celebruar bukuria dhe përsosmëria e irlandishtes, por edhe u formua një paralele mes të drejtës që kishte populli irlandez për ta përdorur këtë gjuhë dhe të drejtës që kishin Moisiu dhe hebrenjtë për të përdorur hebraishten si gjuhë e zbulimit duke mos pranuar gjuhën egjiptiane të detyruar nga sundimtarët e tyre. Siç e dinë të gjithë ideja e Taylor që përdorur gjërësisht në kapitullin "Aedus" të Ulysses, kapitulli i zotëruar nga paraleli mes hebraishtes dhe irlandishtes, dhe një krahasim i tillë paraqet një lloj plotësimi gjuhësor të paralelit mes Bloom dhe Stephen.

Më lejoni atëherë të ngre një dyshim. Në *Finnegans Wake* 356 është fjala *taylorized* që Athernon (*The books at the Wake*) e interpreton si një referim ndaj John Taylor. Nuk kam prova, por më duket interesante që ky citim ndodhet në një kontekst (F. W 353 ff. ku Joyce nis të flasë për *abnihilisation of the etym*, përdor me *how comes every body in our taylorized world to serve out thisthis*, me një referim ndaj fjalës *primeum nobilees* dhe ndaj fjalës *notomise*. Ka mundësi që ideja për të shpikur gjuhë duke anatomizuar dhe prerë rrënjët e fjalëve që frymëzuar nga kjo konferencë e lashtë e Taylor, e shoqëruar nga ndonjë njohje indirekte e Aureicept. Por mbasi nuk ekziston një provë tekstuale e gjithë kësaj nuk mundem veçse të paraqes aluzionin tim si një hipotezë joshëse a thjesht si një zbavitje personale.

Nuk ekzistojnë prova rreth një familjariteti të mundshëm të Joyce me traditat mesjetare irlandeze. Në konferencën: Irlanda ishull i shenjtorëve dhe i Të urtëve, të mbajtur në Trieste më 1907, Joyce dëshiron të këmbëngulë mbi aktivitetin e gjuhës irlandeze, që ai identifikon si një gjuhë fenikase. Joyce nuk ishte një historian i paqortueshëm, dhe gjatë konferencës ngatërroi sikur të ishin i njëjti person Giovanni Scoto Eurigena (që ishte me siguri një irlandez i shekullit IX) me Giovanni Duns Scoto (lindur në Edirburg në shekullin XIII) edhe pse në atë kohë shumë ishin të bindur që qe irlandez; për më tepër besonte se autori i *Corpus Dyonisianum*, ai që e quante "pseudo Aeopagita

Estetikë

Dyonisium" qe shën Dionisi, shenjt i mbrojtës i Francës - ndërsa Dionisi i Corpus u identifikua përmes traditës mesjetare me atë të Dionis Aeropagita që jetoi në kohën e shën Palit; dhe që nga çasti që përkthimi gabonte, autori i vërtetë i Corpus ishte një "pseudo dionis Areopagita" dhe jo një Dionis pseudo Areopagita, siç thoshte Joyce. Por në University College Joyce kishte sudiuar veç latinisht, frëngjisht, anglisht, matematikë, filozofi natyrore dhe logjikë - e pra jo filozofi mesjetare. Në çdo rast të gjitha analogjitë, mes rivendikimeve të gramatikanëve irlandezë dhe kërkimit të një gjuhe të përsosur poetike nga ana e Joyce, janë kaq të mahnitshme sa do të kërkoj të gjej të tjera asociacione.

The Book of Kells

Me qëllim që të përvijojë gjuhën e tij poetike Joyce, edhe pse kishte die jo të sakta rreth traditave të lashta irlandeze, njihte mjaft mir një tekst që e citoi qartë, për herë të parë, në konferencën triestine mbi Irlandën: *The Book of Kells*.

Joyce qysh i ri sigurisht e kishte *The Book of Kells* në Trinity College dhe më vonë, aludoj për një riprodhim, më saktësisht *The Book of Kells, described by Sir Edward Sullivan and illustrated with 24 plates in colour* (botimi II Londër, Paris, Njo Jork 1920): Joyce ia dhuroi një kopje Zonjës Weaver në Krishtlindjet e 1922), edhe pse në vitet e fundit shikimi i tij u keqësua dhe mund të punonte vetëm duke u ndihmuar nga kujtesa.

Kohët e fundit, duke ia paraqitur faksimilen e mrekullueshme të dorëshkrimit Trinity College, kam bërë të ditur se kjo kryevepër e artit irlandez ka qenë paraprirë dhe qarkuar nga një "mërmërimë" dhe jam i sigurtë që, ndoshta në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, Joyce të jetë influencuar nga kjo mërmërimë. Dy ditë më parë kam kaluar një pasdite (për herë të dytë në jetën time) në vendin më magjik të Irlandës, tek Seven Churches of Clonmacnoise dhe edhe një herë kam kuptuar që askush, edhe kush nuk ka dëgjuar kurrë të flitet për gramatikanët irlandezë apo për librat e Kells, të Durrow të Lindisfarne apo të Dun Cow, s'mund të vështrojë këtë panoramë dhe ata gurë të vjetër pa dëgjuar mërmërimën që shoqëron lindjen dhe jetën mijëvjeçare

Estetikë

të The Book of Kells.

Historitë e kulturës latine para mijëvjeçarit, e veçanërisht të shtatë e të dhjetë, regjistrojnë zhvillimin e asaj që është quajtur "estetikë hisperike", një stil që doli dhe u zhvillua nga Spanja, në ishujt britanikë, duke prekur edhe Galinë. Tradita klasike latine e kishte përshkruar (dhe dënuar) këtë stil duke e përcaktuar "aziatik" e më pas "afrikan", në kundërvënie me ekuilibrin e stilit "atik". Kuintiliani në Institui oratoria (XII, 79) të tij kishte nënvizuar se stili i përsosur duhej të tregonte "magna non nimia, sublimia abrupta, fortia non temeraria, severa non tristia, gravia non tarda, laeta non luxuriosa, iucunda non dissoluta, grandia non tumida". Jo vetëm retorika romane, por edhe ajo kristiane antike e dënon kokozelon apo ojnatin e stilit aziatik e si shembull se si qenë skandalizuar thellësisht Etërit e Kishës kur u vunë përballë me shembujt e kësoj mala affectatio, konsiderojnë sharjen e shën Gjerolamit (Adversus Jovinianum I): "Ka një barbari të tillë mes shkrimtarësh dhe ligjërimiti i tyre është bërë kaq konfuz nga veset e ndyra të stilit, sa kemi arritur në një pikë në të cilën nuk ia delet më të merret vesh kush është duke folur dhe për çfarë diskutohet. Çdo gjë (në këto vepra) fryhet për t'u shfryrë më pas, si një gjarpër i dobësuar që copëtohet ndërsa kërkon të shtrembërohet. Gjithçka është ngërdheshur në këto nyje fjalësh të ngatërruara që mund të ripërsëriten me Plautin: "Këtu askush, përveç Sibilës, nuk mund të kuptojë gjë". Po çfarë janë këto djallëzira fjalësh?"

Një thënie e tillë mund të tingëllojë si përshkrim inatçor nga ana e një tradicionalisti, i një faqeje të The Book of Kells apo të Finnegans Wake. Por ndërkohë, diçka duhej të ndodhte: ato cilësi që sipas traditës klasike qenë klasifikuar si vese, në poetikën hisperike do të bëheshin virtyt.

Faqja hisperike nuk i bindet gjatë leximeve të sintaksës e të retorikës tradicionale, modelet e ritmit e të metrit u shkelën me qëllim për të prodhuar elementët e shijes barok.

Zinxhirët e shtrirë të aliteracioneve që bota klasike i kishte konsideruar kakofonike, filluan të prodhojnë një muzikë të re, dhe Aldhelm Mabury (Irtwr Elfrith PL 89, 91) zbavitej me ndërtimin e frazave në të cilat çdo fjalë fillonte me të njëjtën gërmë: "Primitus pantorum procerum praetorum pio pottissimum

paternoque praesertium privilegio panegyricum poematuque passim prosaori sub polo promulgantes ..." leksiku hisperik u pasurua me hibride të panumërta e të pabesueshme duke marrë hua, qoftë tema hebraike, qoftë helenizma, teksti rëndohet me kriptograme që sfidojnë çdo tentativë përkthimi. Nëse ideali i estetikës klasike ishte qartësia, ideali hisperik do të ishte errësira. Nëse estetika klasike ekzaltonte proporcionin, estetika hisperike do të preferonte kompleksitetin, pasurinë e epiteteve e të perifrazave, kolosalen, të përbindshmen, papërmbajtjen, të pamatshmen e të jashtëzakonshmen: I njëjti kërkim i etimologjisë së papranueshme çon në ndarjen e fjalës në elemente atomistike që pastaj fitojnë kuptime enigmatike. Estetika hisperike do të paraqiste stilin e Europës e asaj kohe të errët gjatë së cilës kontinenti i vjetër ishte duke pësuar një rënie demografike, krizën e kulturës, shkatërrimin e qyteteve më të rëndësishme, të rrugëve, të ujësllësve romakë. Në një territor të mbuluar nga pyjet jo vetëm murgjit, por edhe poetët dhe miniaturistët e vështrojnë botën si një pyll të errët, kërcënues, që gëlonte nga përbindëshat, kryqëzuar nga shtigje labirinthesh. Në këto shekuj të vështirë e të çrregullt do të jetë Irlanda që kulturën latine do ta risjellë në kontinent. Por këta murgj irlandezë që kanë përpunuar dhe ruajtur për ne atë pak traditë klasike që arritën të shpëtonin, merrnin inisiativë në botën e gjuhës e të imagjinatës vizive duke kërkuar me hamendje rrugën brenda një pylli të dendur, ngjanin me shokët e shën Brandanos e me të kapërcenin detet duke ndeshur në përbindështa e në ishuj të pashënuar në hartat gjeografike, në një peshk gjigant ku zbarkuan duke e marrë për një ishull, në një ishull të zogjve të bardhë (shpirtrave të rënë me Luciferrin), në shatërvanë të mrekullueshëm, në pemët e Parajsës. Në Guida, të burgosur mbi një shkëmb, të goditur e të munduar nga forca e pandalshme e dallgëve.

Nga shekulli i shtatë dhe i nëntë, ndoshta në tokën irlandeze (por sigurisht në ishujt britanikë) u duk ai Liber monstrorum de diversis generibus që duket se përshkruan mjaft nga shëmbëlltyrat që zbulojmë në The Book of Kells. Autori rrëfen në faqet e para se edhe pse shumë libra të mirënjohur do t'ju kenë treguar gënjeshtër të tilla, nuk do të kishte menduar kurrë t'ua propozonte përsëri nëse "era e vrullshme e kërkesave tuaja nuk do të

kishte mbërritur papritur për të më hedhur picingul, mua - marinarin e trembur - në një det me përbindështa. (...) Atje ishin mbledhur, padyshim, numri i racave të kafshëve detare përbindështe, që me trupat e tyre të pamatshëm, njëlloj me malet e larta, shkundnin dallgët më gjigante dhe trazonin me gjokse hapësirat ujore si t'i shkullnin nga thellësia për t'i shtyrë më pas drejt grykës së qetë të lumenjve: dhe duke notuar çonin shkumëzime e spërkatje, me rropamë të madhe. E rreshtuar kështu ajo ushtri e përbindshme dhe e pafund përshkonte fushat e gjëra të kaltra dhe fshinte ajrin me fshikulimat e shkumëve krejt të bardha - si mermer. Dhe duke përmbysur pastaj me vorbulla të tmerrshme ujërat, si një shakullimë, përmasën e stërmadhe të trupave të tyre e drejtonin në ranishte, si për t' ofruar atij që ishte mbi breg në përgjim, jo aq spektakël se sa tmerr".

Aq sa autori mund të jetë i frikshëm në thënien e gënjeshtreve, nuk mund t'i rezistojë bukurisë humnerore të kësaj gënjeshtre magjepëse, mbasi i lejon të endë një tregim të pafund e të ndryshëm si një labirinth. Tregon historinë e tij me të njëjtën kënaqësi me të cilën në Vita S. Columbani, është përshkruar deti rreth ishullit Hibernia: apo si në Hisperica famina (një vepër me të cilën autori i Liber monstorum duhej të kishte një lloj familjariteti), mbiemra si astriferus apo glaucicomus janë përdorur për të përshkruar shkullmet. (estetika hisperike do të privilegjonte neologjizmat si pectoreus, placoreus, sonoreus, alboreus, proprefurus, flamminger dhe gaudifluus.)

Janë të njëjtat shpikje leksikore të mburrura prej Virgilio Grammatico në veprat e tij Epitamae dhe Epistulae. Shumë eruditë mbështesin që ky fililog i krisur nga Bigorre, një rajon afër Tolosa, që në realitet një irlandez dhe gjithçka - nga stili i tij, në vizionin e tij të botës - duket se e pohon.

Virgjili jetoi në shekullin VII, dhe pra afërmendësh një shekull para prodhimit të The Book of Kells. Citojmë pasazhe nga Ciceroni e nga Virgjili, që këta autorë nuk mund t'i kenë shkruar, por pastaj zbulojmë e perceptojmë se bënin pjesë në një rreth retorësh, ku secili kishte marrë emrin e një autori klasik. Ndoshta Virgjili i shpikte. Ndoshta, siç ka qenë supozuar, shkruante për të përqeshur retorët e tjerë. I influencuar nga kultura keltike, visigote, irlandeze dhe hebraike, përshkoi një univers

Estetikë

gjuhësor që duket se buron nga imagjinata e një poeti surrealist modern.

Pohoi se ekzistonin dymbëdhjetë lloje të latinishtes e se në secilin fjala zjarr mund të jetë e ndryshme: ignis, quoquihabin, ardon, calax, spiridon, rusin, fragon, frumaton, ustrax, vitius, siluleus, aenon (Epitomae, IV, 10). Një luftë i thuhet praelium sepse zhvillohet në det - praelum sepse hapësira e saj krijon supermacinë, apo praelatum, për të dhënë fantastiken e saj. (Epitomae IV, 10). Gjeometria është një art që shpjegon gjithë eksperimentet me barërat dhe bimët, dhe është kjo arsyeja për të cilën mjekët janë quajtur gjeometra (Epitomae IV, II) Retori Aemilius shpalli në mënyrë elegante SSSSSSSS SSS. PP. NNNNNNNN. GGGG.R.MM.TTT.D. CC AAAAAAA. IIIIVVVVVVVV.O.AE.EEEEEEE. - që do të donte të thoshte: "njeriu i ditur thith gjakun e diturisë dhe duhet të jetë i thirrur drejtësisht gjakthithës i venave" (Epitomae X, 1). Galbungus e Terretintus u ndeshën në një diskutim që zgjati katërmëdhjetë ditë e katërmëdhjetë net për të diskutuar mbi thirroren e ego, dhe problemi ishte i një rëndësie të madhe, sepse bëhej fjalë për përcaktimin se si do të duhej t'i drejtoheshe vetes me emfazë. (Oh! ho io ben operato? O egone, recte, feci?") Këtë e të tjera tregon Virgjili duke tërhequr mëndjen e Joyce, që pyeste nëse ishte i vlefshëm pagëzimi me ujë mineral.

Secili prej teksteve që ka gënjyer mund të përdoret për të përshkruar një faqe të The Book of Kells, ashtu si një faqe e Finnegans Wake, sepse në secilën gjuhë bën atë që në The Book of Kells bëjnë shëmbëlltyrat. Të përdorësh fjalë për përshkruar The Book of Kells do të thotë të rishpikësh një faqe të letërsisë hisperike. The Book of Kells është një zbukurim formash të kafshëve, të gërshetuara e të stilisuar, me figura të vogla majmuneske mes një gjethnaje të pazgjdhme që rimbulton faqe pas faqeje, si në vazhdimin e motiveve përherë të njëjta të një sixhadeje muri ku - në realitet - çdo linjë, çdo vastak, paraqet një pamje të ndryshme. Është një kompleksitet në formë spiraleje që bredh qëllimisht i parrahur me çdo rregull të simetrisë së disiplinuar, një simfoni ngjyrash delikate nga e trëndafilta tek e verdha portokall, nga e verdha limon tek e kuqja vjollcë. Katërkëmbësja, zogj, langoj që luajnë me sqepin e një lejleku,

figura të paimagjinueshme njerëzore të shtrembëruara, si një atlet mbi kalë që me kokën mes gjunjëve përdridhet gjer në formimin e një gërme nistore, qenie të përkulshme e të lakueshme si elastike, që ndërhyjnë në një lëmsh të "entrelacs", që shtyjnë kokat e tyre përmes dekoracioneve abstrakte, që mbërthehen fort pas gërmave nistore të futura mes rreshtave. Faqja nuk ndalet nën vështimin tonë, por duket se merr jetë nga vetvetja, nuk ka pika referimi, çdo gjë është e përzier me çdo gjë tjetër. The Book of Kells është mbretëria e Proteo. Është prodhim i një alucinacioni të freskët që nuk ka nevojë për përzierje apo për acid lisergjik për të krijuar honet e tij, edhe pse nuk paraqet delirin e një mendjeje të vetme, por më mirë delirin e një kulture të impenjuar në një dialog në vetveten, duke cituar të tjerë Ungjij, të tjera gërma miniatura, të tjera tregime.

Është marramendja e ndritshme e një gjuhe që kërkon të ripërcaktojë botën ndërsa ripërcakton vetveten me vetëdije të plotë, që në një kohë ende të pasigurtë, çelësi i zbulimit të botës të mos gjendet në një vijë të drejtë, por në një labirinth. Nuk është pra rastësi që gjithë kjo të ketë frymëzuar Finnegans Wake në çastin kur Joyce tentonte të realizonte një libër që paraqiste në të njëjtën kohë një shëmbëlltyrë të universit dhe një vepër për "një lexues ideal, i prekur nga një pagjumësi ideale."

Por edhe përse i përket Ulysses Joyce kishte deklaruar që shumë nga inicialet e The Book of Kells në librin e tij zotëronin karakterin e një kapitulli të tërë dhe kërkonte hapur që vepra e tij të ishte krahasuar me ato miniatura.

Kapitulli i Finnegans Wake që i referohet The Book of Kells është ai i quajtur konvencionalisht "The manifest of Alp". Në këtë kapitull është treguar historia e një gërme të gjetur mbi një grumbull plehu ("një simbol ... i botës së banuar në të cilën njerëzit kanë lënë gjurmë ... Gërma është një simbol i gjithë përpjekjeve të komunikimit të shkruar që përfshin të gjitha gërmat e tjera, gjithë letërsinë e botës, The Book of Kells, gjithë dorëshkrimet, gjithë tekset e shenjta të botës dhe vetë Finnegans Wake". Faqja e The Book of Kells në të cilën Joyce gjen frymëzim të madh është "tenebrous Tunc page" (fleta 124). Po t'i hedhësh një sy kësaj faqeje të Tunc duke treguar në mënyrë simulante, edhe pse më ndërprerje, ndonjë rresht të Joyce, ke përshtypjen se flitet për një

përvojë me mjete heterogjene në të cilën gjuha pasqyron shëmbëlltyrat e miniaturave dhe shëmbëlltyrat e miniaturave zbulojnë analogji gjuhësore.

Joyce flet për një faqe në të cilën "çdo person, vend a send në kozmosin e Gjithënjëmënyre në marrëdhënie me kokorisjen e gjeldetit lëviz duke transformuar çdo pjesë kohe". Flet për një "monolog të vazhdueshëm të brendësisë" ku "një fjalë dinakërisht e burgosur në labirinthin e saj në konfuzion merr një pozë madhështore si një mi fushe në një çerdhe me shirita të ngjyrosur", shndërrohet në "një keqeshkronje ostrogote" formuar prej "një majtasrrotullimi të papritur drejt një pike të veçantë të dhimbshme të së kaluarës" që tregon se si fjalët që vijnë pas mund të jenë mbledhur në rendin e dëshiruar ..."

Çfarë paraqet pra The Book of Kells? Dorëshkrimi i vjetër na flet për diçka që mund të njohim. Flet për një botë të bërë prej shtigjesh që bigëzohen në drejtime të kundërta, për aventurat e mendjes e të imagjinatës që nuk mund të përshkruhen dot. Flitet për një strukturë në të cilën çdo pikë mund të bashkëlidhet me çdo tjetër, ku nuk ka pika e vendosje, por vetëm vija lidhëse, secila prej tyre mund të jetë e ndërprerë në çdo çast, mbasi do të marrë të ndjekë menjëherë të njëjtin drejtim. Mund të jetë e ndërprerë dhe e përmbytur, nuk ka as qendër, as periferi ... Libri The Book of Kells (bashkë me Finnegans Wake, pasardhësin e tij) paraqet modelin e gjuhës njerëzore dhe, ndoshta këtë botë në të cilën jetojmë. Ndoshta jetojmë në Encyclopédie të Diderosw.

The Book of Kells është një labirinth. Kjo është arsyeja për të cilën arriti të bëhej në mendjen e shqetësuar të Joyce, modeli i një libri të papërfunduar, i lexueshëm vetëm nga "një lexues ideal i prekur nga një pagjumësi ideale" Por në të njëjtën kohë qoftë The Book of Kells, qoftë Finnegans Wake janë shëmbëlltyra më e mirë e universit, ashtu siç është paraqitur nga shkenca bashkëkohore. Janë modeli i një universi në ekspansion, ndoshta i mbaruar e prapëseprapë i pakufizuar, pikë nisjeje për pyetje të pafundme. Ne pranojmë të ndjehemi burra dhe gra të kohës sonë edhe nëse lundrojmë në të njëjtin det të rrezikshëm që çoi shën Brandanon në kërkim të atij Ishulli të Humbur për të cilin The Book of Kells këndon në çdo faqe, ndërsa na fton e na frymëzon të vazhdojmë kërkimet tona për të arritur dhe për të

shprehur në mënyrë të përsosur botën në të cilën jetojmë.

Jim "bachelor" nuk ishte aspak i paplotësuar, sepse parashihte si në mjegull cila ishte detyra e tij dhe çfarë duhej të kuptonim ne, vlen të thuhet se ambiguiteti gjuhësor, papërsosmëria natyrale e idomave tona, nuk paraqesin mikrobin pas - babelik nga i cili njerëzimi duhet të shërohet, por përkundrazi, të vetmen mundësi që Zoti i kishte dhënë Adamit, kafshës folëse. Të kuptosh gjuhët njerëzore, të papërsosura e të afta në të njëjtën kohë për të realizuar papërsosmërinë supreme që e quajmë poezi, paraqet konkluzionin e vetëm të çdo kërkimi të papërsosmërisë. Babeli nuk qe një incident, jetojmë në Kullë që nga origjina, dialogun e parë mes Zotit e Adamit e kemi në finneganin, dhe vetëm duke u kthyer nga Babeli dhe duke pranuar mundësinë tonë të vetme mund të gjejmë paqen tonë dhe të përballojmë fatin e racës njerëzore.

E gjithë kjo histori nisi në Dublin, kur një djalë filloi të ishte i obsesionuar nga The Book of Kells, nga Durrow, nga Lindisfarne, nga Dun Cow... "Once upon the time there was a Dun Cow coming down along the maze and this Dun Cow that was down along the maze met a nicens little boy named baby Jim the bachelor ..."

*Përktheu nga italishtja:
Alfred ÇAPALIKU*